



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 86/2012
Prishtinë, më 04.12.2012, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N–225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti – kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha–Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi dhe Myzejene Selmani.

Munguan: Fikrim Damka, Berat Buzhala dhe Biserka Kostiq.

Pjesëmarrës të tjerë: Dukagjin Shala dhe Fazile Bekteshi – MZHE; Ukë Gashi - ZPRK; Dita Dobranja – INDEP; Shkelzen Gërxhaliu dhe Liridona Doberdolani – NDI praktikant dhe Florije Mehmeti - KDI.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti- kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 20 dhe 21.11.2012;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për miniera dhe minerale;
4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin Nr. 04/L-154 për punimet nga metalet e çmuara;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Deputetët u pajtuan që pika IV e rendit të ditës në lidhje me: Shqyrtimin e Raportit me Rekomandime për Projektligjin Nr. 04/L-154 për punimet nga metalet e çmuara; **të hiqet nga rendi i ditës**, si e pa nevojshme për shqyrtim, pasi që komisionet e përhershme nuk kanë pasur vërejtje. Nga kryetari i komisionit kërkuan që të procedojë tutje për lexim të dytë.

Komisioni miratoi rendin e ditës si vijon:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 20 dhe 21.11.2012;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligji Nr. 04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për miniera dhe minerale;
4. Te ndryshme.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 20 dhe 21.11.2012

Procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 20 dhe 21.11.2012 u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligji Nr. 04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për miniera dhe minerale

Kryetari – Tha se tanimë kemi në shqyrtim në parim projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për miniera dhe minerale, të cilin e kemi hartuar vetë ne, si Komision. Dhe e hapi debat në parim.

Lutfi Zharku - Paraqiti vërejtje në parim në lidhje heqjen e procedurave tenderuese; garancinë bankare; bazat e betonit dhe të asfaltit; shkallën e interesit të vendosur nga KPMM; planin hapësinor; mbrojtjen në punë; si dhe mënyrën e zgjedhjes së drejtorit dhe të inspektorit të KPMM-së, respektivisht këto vërejtje ishin në nenet 14, 24, 27, 30, 31, 33, 36, 37,38 dhe 40.

Visar Ymeri - Paraqiti dilemën në lidhje me propozimet e reja të Qeverisë edhe pse Qeveria ka qenë gjatë gjithë procesit të hartimit të projektligjit, ndërsa tani ka sjellë krejtësisht propozime të reja. Në fund tha se po qe se merren edhe propozimet e Qeverisë dhe inkorporohen në projektligj atëherë del se po hartohet një ligj komplet i ri e jo plotësim- ndryshim.

Myzejene Selmani – Tha se ne, si Komision, jemi sponsorues të këtij projektligji dhe kërkoj që të procedohet në Kuvend dhe pastaj në Komision të shqyrtohet nen për nen në procedurë të rregullt, sikurse në çdo projektligj.

Sala Berisha Shala - Në fillim i dha sqarimet në detaje në lidhje me vërejtjet e z. Zharku, dhe pastaj tha se si grup punues, por edhe si Komision, jemi pajtuar që t'i vendosim të gjitha propozimet në projektligj. Pastaj kur të vije projektligji në Kuvend, pas mendimit të Qeverisë, ne mund të bëjmë ndërhyrjet tona. Përveç të tjerash ajo tha se për disa nene as vetë nuk është pajtuar, sikurse nuk janë pajtuar as disa deputetë të tjerë. Mirëpo kemi vendosur që të përfshihen të gjitha propozimet siç e ceku më lart. Ajo shfaqti shqetësimin në lidhje me propozimet e shumta të Qeverisë dhe po ashtu tha se Qeveria ka qenë gjatë gjithë kohës me neve gjatë hartimit, ndërsa tani pas mendimit kanë sjellë propozime krejtësisht të reja dhe ne nuk e dimë a janë substanciale ose teknike, sepse janë pa arsyetim.

Kryetari - Tha se ne është mirë ta procedojmë për Kuvend në lexim të parë dhe pastaj grupi punues të punojë rreptë me të gjitha palët e interesit dhe të mbajë dëgjime publike sipas procedurës së rregullt sikurse për çdo projektligj.

Mbledhja u ndërpre në mungesë të kuorumit.

4. Të ndryshme
Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit